



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

**VENDIM**

**Nr. 3, datë 04/04/2022**

**MBI**

**“ MIRATIMIN E TARIFAVE TË KONKURRIMIT, TARIFËS SË  
REGJISTRIMIT, TARIFËS SË SHKOLLIMIT PROGRAM I PARË  
STUDIMI SI DHE TARIFËS SË SHKOLLIMIT PROGRAM I DYTË  
STUDIMI PËR TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT TË OFRUARA  
NGA FAKULTETET E UNIVERSITETIT TË ARTEVE, PËR VITIN  
AKADEMIK 2022-2023”**

Mbështetur në pikat 28, 29, dhe 30, të nenit 6 dhe nenit 38 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Senatit Akademik të Universitetit të Arteve Nr. 18, datë 10.03.2022 “Mbi propozimin për miratimin e tarifave të konkurrimit, tarifës së regjistrimit, tarifës së shkollimit program i parë studimi si dhe tarifës së shkollimit program i dytë studimi për të gjitha programet e studimit të ofruara nga fakultetet e Universitetit të Arteve, për vitin akademik 2022-2023” nisur dhe nga propozimet mbi deklarin e tarifës së konkurrimit, tarifës së regjistrimit si dhe tarifës së shkollimit për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë dhe të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë, të ofruara nga Fakultetet e Universitetit të Arteve, bashkëlidhur këtij vendimi dhe më konkretisht shkresave të: Fakultetit të Artit Skenik, Nr. 43 Prot., datë 14.02.2022; Fakultetit të Muzikës, Nr. 39 Prot., datë 14.02.2022 dhe Fakultetit të Arteve të Bukura, Nr. 21 Prot., datë 14.02.2022, pasi i mori në shqyrtim dhe i diskutoi ato, me votim të hapur,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e tarifës së konkurrimit, tarifës së regjistrimit dhe tarifës së shkollimit për program të parë dhe të dytë studimi për të gjitha programet e studimit të ofruara nga Fakultetet e Universitetit të Arteve, sipas tabelave bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim ti dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
3. Ky vendim ti dërgohet Administratores dhe Fakulteteve të Universitetit të Arteve për zbatim.
4. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare elektronike të Universitetit të Arteve dhe të transparenca.

**0-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë..**



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

**Z. Lavdrim SAHITAJ**

  
\_\_\_\_\_  
(Kryetar)

**Prof. Besnik Bisha**

  
\_\_\_\_\_  
(Anëtar)

**Prof. Asoc.Dr.Sokol SARAÇI**

  
\_\_\_\_\_  
(Anëtar)

**Z. Ergis SEFA**

  
\_\_\_\_\_  
(Anëtar)

**Z. Jeton SHEHU**

  
\_\_\_\_\_  
(Anëtar)

**Z. Lorenc VANGJELI**

\_\_\_\_\_  
(Anëtar)

**As.Lek. Vladimir Llakaj**

\_\_\_\_\_  
(Anëtar)